Flishi eshte nje sekuence prej shkembinjsh sedimentare te depozituara ne shtresat e thella detare ne basenin e kepit behet me e holle dhe molaset depozitohen siper flishit. Prandaj dhe ajo quhet sedimete syn-orogjenike (te depozituara njekohesisht me ndertimin e maleve).

Gjeologjia e rruges eshte kryesisht e formuar nga shkembinj kalcite (gur gelqeror, dolomite dhe gelqeror-argjilor dhe gelqeror ne argjinature.

Vetem ne pjesen e fundit, ka formacion argjilore te vjetra. Brenda masës argjilore ne pjesën e poshtme te shpatit (ne krahun e djathtë te rrugës) takohen edhe olistolite gëlqerorësh me përmasa 5 deri 10 metra.

Gjate rikonicionit, studimi gjeologjik eshte bere bazuar ne pershkrimin litologjik sesa ne stratigrafi. Kjo nenkupton qe vezhgimet gjeologjike dhe komentet e raportuara me siper i referohen karakteristikave dhe konstruimit te copave te shkembinjeve te shkeputura, pavaresisht moshes se tyre.

Rruga ka seksione mbushje/germimi pothuajse gjate gjithe gjatesise se saj.

FORMACIONET GJEOLOGJIKE

SHTRESA 1

Perfaqesohet nga suargjila te lehta çakellore me ngjyre bezhe me lageshtire dhe ne gjendje plastike.Permbajne copa çakelli dhe zhavori me madhesi te ndryshme.Jane mesatarisht te ngjeshura.Takohet ne thellesite shiko prerjen gjeologjike ne aksin e rruges se re.
Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja *granulometrike*

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	16.50 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.05 mm	22.60 %
Fraksioni rere dhe zhavor	> 0.05 mm	60.90 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	W_{rr} = 32.70 %
Kufiri i poshtem i plasticitetit	W_p = 21.50 %
Numri i plasticitetit	F = 11.20
Lageshtia natyrore	W_n = 20.40 %

Pesha specifike	Δ =□2.71 T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale	γ□ =□1.96 T/m^3
Koeficienti i porozitetit	ε = 0.68
Grada e lageshtise	G = 0.90
Moduli i deformacionit	E = 120 kg/cm^2
Koefiçienti i ngjeshjes	α = 0.024 cm^2/kg
Moduli i uljes	S = 22.60 mm/ml
Kendi i ferkimit te brendshem	φ = 26^o
Kohezioni	C = 0.12 kg/ cm^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	σ = 1.80 kg/cm^2
Treguesi i CBR	CBR = 8-10%

SHTRESA 2

Perfaqesohet nga suargjila te lehta çakellore me ngjyre bezhe me lageshtire dhe ne gjendje plastike.Permbajne copa çakelli dhe zhavori me madhesi te ndryshme.Jane mesatarisht te ngjeshura.Takohet ne thellesite shiko prerjen gjeologjike ne aksin e rruges se re.
Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike

Fraksioni argjilor	< 0.002 mm	16.50 %
Fraksioni pluhuror	0.002-0.05 mm	22.60 %
Fraksioni rere dhe zhavor	> 0.05 mm	60.90 %

Plasticiteti

Kufiri i siperm i plasticitetit	W$_{rr}$ = 32.70 %
Kufiri i poshtem i plasticitetit	W$_p$ = 21.50 %
Numri i plasticitetit	F = 11.20
Lageshtia natyrore	W$_n$ = 20.40 %
Pesha specifike	Δ □=□ 2.71 T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale	γ□ =□ 1.86 T/m^3
Koeficienti i porozitetit	ε = 0.68
Grada e lageshtise	G = 0.90
Moduli i deformacionit	E = 90 kg/cm^2
Koefiçienti i ngjeshjes	α = 0.024 cm^2/kg
Moduli i uljes	S = 22.60 mm/ml
Kendi i ferkimit te brendshem	φ = 26^o
Kohezioni	C = 0.1 kg/ cm^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	σ = 1.70 kg/cm^2
Treguesi i CBR	CBR = 5-7%

SHTRESAT 3

Perfaqesohet nga gelqerore me ngjyre te bardhe ne gri me çarje te forte. Çarjet e shkembit ne disa raste jane te mbushura me lende argjilore ne disa raste jane bosh. ne keto shkembinj konstatohen dhe boshlleqe karstike me permasa te ndryshme.Jane shkembinj me karateristika te mira rekomandohet te perdoren si materiale ndertimi. Takohet ne segmentet e ndryshme shiko prerjen gjeologjike te rruges:

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Lageshtia natyrore	W_n = 2.30 %
Pesha specifike	Δ =□2.78 T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale	γ =□2.66 T/m^3
Koeficienti i porozitetit	ε = 0.22
Kendi i ferkimit te brendshem	φ = 45^o
Kohezioni	C = 0.85 kg/ cm^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	σ = 5.20 kg/cm^2
Rezistenca ne shtypje njeboshtore	Rsh = 700.0 kg/cm^2
Moduli i deformacionit	E = 26457.51MPA
Treguesi i cilesise	GSI = 70
Treguesi i cilesise se shkembit RQD	RQD = 65-80%
Treguesi I CBR	CBR = 145-160%

SHTRESA 4

Perfaqesohet nga shkembinj efuzivo sedimentare qe perbehen nga rreshpe argjilore Jane me çarje dhe te perajruar. jane me karakteristika mesatare.Materiali qe mund te krijohet nga germimet e ketyre shkembinjve nuk mund te perdoret per mbushje. Takohet ne thellesite; shiko prerjen gjeologjike ne aksin e rruges

Karakteristikat fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Lageshtia natyrore	W_n = 9.40 %
Pesha specifike	Δ =□2.72T/m^3
Pesha volumore ne gjendje natyrale	γ □ =□2.54 T/m^3
Koeficienti i porozitetit	ε = 0.34
Kendi i ferkimit te brendshem	φ = 30^o
Kohezioni	C = 0.60 kg/ cm^2
Ngarkesa e lejuar ne shtypje	σ = 4.20 kg/cm^2
Treguesi I CBR	CBR = 10-15%
Rezistenca ne shtypje njeboshtore	Rsh = 80.0-100 kg/cm^2
Moduli i deformacionit	E =2520.84 MPA
Treguesi i cilesise	GSI = 48
Treguesi i cilesise se shkembit RQD	RQD = 35-40%

5.3 INVESTIGIMET NE SHTRESAT RRUGORE EKZISTUESE

5.3.1 Te pergjithshme

Studimet gjeoteknike ne terren per tre segmentet e rruges (total 10.05 km) jane bere ndermjet Prillit dhe Korrikut 2011. Jane permbushur detyrat vijuese te studimit.

- Vleresim vizual
- Shpime studimore
- Vleresimin mbi materialet e ndertimit

Objektivi i ketij studimi gjeoteknik eshte te percaktoje dhe optimizoje rehabilitimin e shtrimit te rruges duke konsideruar gjendjen aktuale te rruges dhe materialet e ndertimit ne dispozicion.

Eshte bere nje studim i detajuar i shtresave te rruges per te patur mundesine e:

- Perfshirjen e shtresave ekzistuese dhe shtresat e reja te rruges;
- Riperpunimin e materialeve te shtresave ekzistuese per shtresat e meposhtme te rruges;
- Konsiderimi i rikonstruksionit ku shtresat ekzistuese jane te shkaterruara.

5.3.2 Pershkrimi vizual i shtresave te rruges

Gjendja e shtrimit te rruges u krye ne menyre qe te krijohet nje ide mbi gjendjen e siperfaqes se rruges ne termat e difekteve dhe prishjeve te rruges dhe per te identifikuar shkaqet e ndodhjes se ketyre prishjeve ne menyre qe te ndermerren masa permiresuese ne projektimin e ri te shtresave te rruges dhe ne fazen e ndertimit te tyre. Pervec ketyre, ky investigim u be ne menyre qe te identifikoheshin zonat ku nenshtresa eshte e dobet dhe zonat ku cilesia dhe kapaciteti i sjelljes se materialit te shtresave nuk eshte ajo e duhura.

Per sa i perket shtrimit, ajo eshte nje rruge me shtresa te siperme asfaltike te demtuara (shih formularet e azhronimit per cdo lot, Aneks 5.1) dhe ne segmente te vecante vetem me shtresa çakelli ose zhavorri.

Me poshte po japim disa fota ilustruese te gjendjes se shtresave per cdo segment

Figura 41. Foto nga segmenti 1

Figura 42. Foto nga segmenti 2

Figura 43. Foto nga segmenti 3

5.3.3 Gropat studimore

Gropa studimore jane bere pergjate rruges per te percaktuar strukturen e shtresave ekzistuese te rruges dhe per te vleresuar cilesine e materialeve ne menyre qe te riperdoren ne forcimin, rehabilitimin dhe rikonstruksionin e rruges.

Gropat jane hapur çdo 500 m duke iu referuar Termave te References. Bazuar ne inspektimin vizual, vendndodhja e gropave eshte vendosur ne ato pjese ku ishte kryer dhe pershkrimi dhe mbledhja e mostrave.

Pershkrimet e ketyre gropave kane filluar qe ne km. 0+300.00. Gropat ndodhen 0.5 m nga karrexhata dhe jane me madhesi 0.5 x 0.5 dhe i thelle ne madhesine qe te arrije token natyrale.

Per secilen nga gropat eshte regjistruar informacioni i meposhtem:

1 trashesia e shtresave;
2 lloji i materialit te perdorur dhe prejardhja e mundshme e tij;
3 cilesia e shtreses bituminoze;
4 ndonje nderhyrje qe eshte kryer ne shtresat ekzistuese, si rimbushje ose ndryshim etj.

Duke kombinuar te dhenat e ketyre gropave (cilesine dhe trashesine) me vleresimin vizual, jane verejtur ndryshime te medha te shtresave pergjate tre segmenteve te rruges.

Rruga eshte e pjeserisht e shtruar ne gjithe gjatesine e saj. Shtresat per cdo segment konsiston ne shtresa asfaltike nga 4-8,10cm dhe mbushje granulare nga 8-20cm (ndonjehere i perzier me zhavorr natyral).

Stratigrafia e shtresave per cdo segment jepet si me poshte.



Figura 44. Shtresat ekzistuese

5.3.4 Bazamenti dhe rezultatet e provave laboratorike te shtresave ekzistuese

Bazuar ne rezultatet e gropave te kontrollit, vendet e meposhtme jane identifikuar si perfaqesues te te gjithe cilesise se **bazamentit**: Ne keto vendndodhje u morren mostrat dhe u kryhen provat rezultatet e se cilave jane dhene me siper

Rezultatet tregojne dy lloj bazamentesh. Ne segmentin e pare, pothujase deri ne uren mbi Kir, eshte prezent nje bazament i nje cilesie mesatare, me aftesi mbajtese ndermjet 10 dhe 14 (mesatare 12.00), qe nenkupton nje klase cilesie bazamenti S4 dhe ne vende te vecanta CBR varion nga 15-20 qe nenkupton nje klase cilesie bazamenti S5. Ne segmentin e dyte dhe te trete, eshte prezent nje material me pak cilesor: aftesia mbajtese eshte ndermjet 8-14 dhe ne vende te vecanta 5-7, qe nenkupton nje klase fortesie te bazamentit S4 dhe S3.

Rezultatet tregojne nje cilesi te mire te materialit te shtresave ekzistuese (mesatare CBR ne 95% MDD eshte 49.0), i cili mund te inkorporohet me shtresat e reja pergjate gjithe rruges me perjashtim te km te fundit.

5.4 STUDIMI MBI MATERIALET E NDERTIMIT

Burime ekzistuese te materialeve te ndertimit (karriera, impiante fraksionimi, impiante asfalto-betoni, etj.) qe ndodhen ne zonen e projektit. Keto burime jane identifikuar dhe pershkruar si me poshte.

Impianti me i afert i fraksionimit dhe asfaltit eshte ne Shkoder, rreth 23 km larg nga projekti i rruges.

Gjate rruges eshte nje gur gelqeror i nje cilesie te mire qe mund te perdorur per te prodhuar stabilizant, agregat per betonin dhe per asfalto-betonin e shtreses se binderit.

Ne kemi studiuar mostra te gurit gelqeror te perdorur nga keto karriera. Pasi kryem testin Los Angeles, rezultatet qe morrem jane:

Prejardhja	Madhesia	Los Angeles
Test n. 1	19 mm	27.9

Burimet e ujit te nevojshme per punimet e betonit dhe kompaktesimit jane te bollshme ne afersi te shtrirjes se rruges per shkak te prezences se disa perrenjve ne zone.

5.5 LLOGARITJA E SHTRESAVE

Ne projektin e rrugeve rurale llogaritja e shtresave kalon neper keto etapa:

- percaktimi I trafikut llogarites (ne ESAs, 8,2 T) bazuar ne jetegjatesi 20vjet
- identifikimi i seksioneve homogjene dhe stategjise se rehabilitimit bazuar ne shtresat ekzistuese, konditat dhe cilesia e tyre
- zgjedhja e paketes se shtresave bazuar ne "*Road Design Guidelines*" te ADF qe japin sherbyeshmeri te kenaqshme
- kontrrolli I dimensioneve te shtresave te rehabilituara me ane te metodes se Numurit Struktural

5.5.1 Vleresimi I trafikut

Trafiku i projektimit te shtresave eshte vleresuar sipas Udhezimeve te FShZh (dhjetor 2010). Jane bere matjet e trafikut te enjten 7 Mars 2013 per 1 ore (12^{00}-13^{00}). Sipas Udhezimeve te FShZh dy drejtimet e numeruar jane rregulluar nepermjet faktoreve qe tregohen ne tabelen e meposhtme 5.2. per shkak te diferencave mjaft te medha ne trafikun e secilit segment vleresimet po i japim te ndara sipas çdo segmenti.

Table 5-2: Adjustment Factors for Short-term Traffic Counts

MONTHLY AVERAGE	Week	Mon-Thu	Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
January	1.22	1.20	1.43	1.24	1.17	1.18	1.13	1.02	1.36
February	1.19	1.21	1.36	1.18	1.23	1.21	1.11	0.95	1.26
March	1.06	1.09	1.11	1.11	1.10	1.06	1.00	0.88	1.12
April	1.01	1.05	1.06	1.06	1.06	1.02	0.96	0.85	1.06
May	0.97	1.02	1.01	1.02	1.03	1.01	0.93	0.79	0.99
June	0.93	0.98	0.94	0.99	0.99	0.95	0.89	0.78	0.94
July	0.92	0.98	0.91	0.98	0.99	0.98	0.89	0.77	0.90
August	0.91	0.97	0.91	0.98	0.99	0.95	0.89	0.77	0.92
September	0.99	1.04	1.02	1.04	1.05	1.03	0.97	0.82	1.01
October	0.99	1.05	0.99	1.06	1.06	1.03	0.95	0.82	1.03
November	0.99	1.01	0.98	1.08	1.01	0.93	1.01	0.90	1.04
December	1.11	1.10	1.36	1.19	1.08	1.02	1.01	0.93	1.14

Tabela 28. Faktoret e korrigjimit te trafikut

Kater tipe mjetesh jane konsideruar me qellim per te percaktuar trafikun e projektimit: Mbus, kamion i lehte, kamion i rende, trajler i artikuluar.

Segmenti I

Shkoder- kryqezim 2	MBus	Kamion i lehte	Kamion i rende	Trajler
07/03/2013	27	28	6	3
Llogaritjet e rregulluara				
07/03/2013	30	31	7	3
AADT	272	282	35	15

Kryqezim 2- Postribe	MBus	Kamion i lehte	Kamion i rende	Trajler
07/03/2013	33	10	2	
Llogaritjet e rregulluara				
07/03/2011	36	11	2	
AADT	327	100	10	

Tabela 29. Matjet e trafikut

Ne menyre qe te percaktohet totali i ESAs ne 20 vite trafiku aktual AADT ne dy drejtime, eshte projektuar duke marre parasysh nje rritje vjetore te barabarte me 2% deri ne fund te punimeve (2015) dhe nje tjeter rritje vjetore 4% nga 2015 (hapje e rruges per trafik) deri ne 2036 (fundi i jetegjatesise se projektit). Faktoret e ekuivalences qe jane marre parasysh jane 0.1, 6.5,11.5, 12 perkatesisht per Mbus, Kamionet e lehte, Kamionet e rende dhe trajlerat e artikuluar.
Per sa i perket faktorit te korsise se trafikut nje vlere prej 75% eshte adoptuar per gjeresi rruge 4m.

LLOGARITJA E TRAFIKUT esal AASHTO

koha punes y=	20
rritja vjetore r=	0.04
Gy=	29.77808

TIPI I MJETIT	E.F. KRYESORE (8,16 tons)	AADT NE 2013- dy drejtime	AADT ne 2015 (a.g.r 2%) dy drejtime	AADT ne 2015 (hapja) nje drejtim (75%)	Mjetet e akumuluara nje drejtim mbi 20 vjet (2015 - 2035 / a.g.r. 4%)	Total 10^6 ESALs	KLASA e Trafikut
MBus	0.1	272	278	**209**	**227162**	**0.23**	
Kamion i Lehte	0.42	282	288	**211**	**963211**	**0.96**	
Kamion i rende	1	35	36	**27**	**293463**	**0.29**	
Trajler Artikuluar	1.2	15	15	**11**	**143471**	**0.14**	
						1.63	**T4**

Tabela 30. Nxerrja e klases se Trafikut

ESALs totale e llogaritur (80 KN) ne 20 vjet (2015-2035) eshte keshtu 1.63 10^6 (klasa T4 ne Udhezimet per projektimin e rrugeve te FShZh), dhe kjo klase trafiku T4 mund te konsiderohet e pershtatshme per analizen e projektimit e shtresave qe paraqitet ne vijim.

Per zonen nga kryqezimi deri ne Postribe qender do te kemi:
LLOGARITJA E TRAFIKUT esal AASHTO

koha punes y=	20
rritja vjetore r=	0.04
Gy=	29.77808

TIPI I MJETIT	E.F. KRYESORE (8,16 tons)	AADT NE 2013- dy drejtime	AADT ne 2015 (a.g.r 2%) dy drejtime	AADT ne 2015 (hapja) nje drejtim (75%)	Mjetet e akumuluara nje drejtim mbi 20 vjet (2015 - 2035 / a.g.r. 4%)	Total 10^6 ESAs	KLASA e Trafikut
MBus	0.1	327	334	**250**	**271893**	**0.27**	
Kamion i Lehte	0.42	100	102	**77**	**349221**	**0.35**	
Kamion i rende	1	10	10	**8**	**83148**	**0.08**	
trajler	1.2		0	**0**	**0**	**0.00**	
						0.70	**T3**

Tabela 31. Nxerrja e klases se Trafikut

ESALs totale e llogaritur (80 KN) ne 20 vjet (2015-2035) eshte keshtu 0.7 10^6 (klasa T3 ne Udhezimet per projektimin e rrugeve te FShZh), dhe kjo klase trafiku T3 mund te konsiderohet e pershtatshme per analizen e projektimit e shtresave qe paraqitet ne vijim.

Per segmentin Postribe - Drisht dhe Drisht - Kala Drisht nga regjistrimet e trafikut dhe historiku i performances se rruges rezulton se nuk mund te bejme nje vleresim bazuar vetem ne ESAL por duhet bere nje vleresim analitike per ngarkese te perqendruar te rrotes maksimale qe mund te kaloje ne rruge. Ne funksion te kesaj kjo ngarkese maksimale mund te ekuvalentohet ne ngarkese tip T2.

5.5.2 Seksionet homogjene dhe strategjia per rehabilitimin e shtresave

Sic u permend, duke kombinuar provat laboratorike dhe trashesite, rruga eshte ndare ne disa seksione homogjene kryesore si vijon:

1. Nga km. 0+000 deri ne km. 0+540 (rruge e totalisht e shkaterruar) trashesia mesatare dhe fortesia e bazamentit per kete interval eshte si vijon:
   - shtresa e zhavorrit perzierre me copa asfalti:18- 20 cm;
   - klasa e fortesise se bazamentit S4 (CBR = 8-14)

2. Nga km. 0+540 deri ne km. 3+600 (rruge e shtruar) trashesia mesatare dhe fortesia e bazamentit per kete interval eshte si vijon:
   - Shtresa te demtuara asfaltike 8-10cm
   - shtresa e zhavorrit: 18 cm;
   - klasa e fortesise se bazamentit S4 (CBR = 8-14)

3. Nga km 4+050(0.00 Lot 2) deri ne km. 7+050(3+00 Lot 2) (rruge e shtruar) trashesia mesatare dhe fortesia e bazamentit per kete interval eshte si vijon:
   - Shtresa te demtuara asfaltike 8cm
   - shtresa e cakkellit/zhavorrit: 15-16 cm;
   - klasa e fortesise se bazamentit S4,3 (CBR = 8-14, CBR=5-7)

4. Nga km. 7.05 (0+00 Lot 3) deri ne km. 9+100 (2.1 Lot 3) (rruge e shtruar) trashesia mesatare dhe fortesia e bazamentit per kete interval eshte si vijon:
   - Shtresa asfaltike(demtime sporadike) 8-10cm
   - shtresa e cakellit: 15+20 cm;
   - klasa e fortesise se bazamentit S4 (CBR = 8-14)

5. Nga km. 9+100 (2.1 Lot 3) deri ne km. 10+050 (3.020 Lot 3) (rruge e shtruar) trashesia mesatare dhe fortesia e bazamentit per kete interval eshte si vijon:
   - Shtresa totalisht te demtuara asfaltike 8-10cm
   - shtresa e cakellit: 12 cm;
   - klasa e fortesise se bazamentit S3,4 (CBR = 5-7; CBR = 8-14)

Ndarja ne seksione homogjene eshte bere ne baze te inspektimit vizual te shtresave, trashesive te shtresave ekzistuese dhe rezultateve te testeve te bazamentit (treguar me siper).

Shtresa ekzistuese e zhavorrit mund te inkorporohet ne ndertimin e paketes se re te shtresave si nje shtrese nenbaze, dhe nje shtrese e re baze dhe shtresa e asfalto-betonit do te vendosen mbi te.

Bazuar ne "*Udhezimet e Projektimit te Rrugeve*" te FSHZH per nje klase bazamenti S4 dhe S5 dhe nje trafik te klases T3 sugjerohet paketa e poshtme e shtresave (shih grafikun 3).

Shtresa	**Materiali**	**Trashesia**	
		bazamenti S4	**bazamenti S5**
Tapeti	Asfalto beton	50 mm	50 mm
Shtresa baze	Gur i thyer	175 mm	150 mm
Bazamenti	Zhavor natyral/ i copetuar	150 mm	100 mm

Tabela 32. Paketa e shtresave sipas RDG

Po ne "*Udhezimet per projektimin e Rrugeve*" parashikohet nje strukture shtresash specifike per rruget dytesore/lokale te perbere nga tapeti (30 mm) dhe binderi (50 mm) si ne tabelen e meposhtme.

Shtresa	**Materiali**	**Trashesia**
Tapeti	Asfalto beton	30 mm
Shtrese Binderi	Asfalto beton	50 mm
Shtresa e bazes	Gure i thyer	varion
Bazamenti	Zhavorr natyral	varion

Tabela 33. Nxerrja e klases se Trafikut

Struktura e pare e shtresave ka nje SN (Numer Struktural) te barabarte me 6.30 dhe 5.40, i llogaritur si me poshte: SN percaktohet duke konvertuar trashesine e shtreses se siperfaqes, bazes dhe bazamentit dhe duke i percaktuar nje koeficient te shtreses qe perfaqeson fortesine relative te materialit te perdorur per cdo shtrese.

$SN = (a_1 \times T_1) + (a_2 \times T_2 \times m_2) + (a_3 \times T_3 \times m_3)$

Ku: T_i perfaqeson trashesine e shtreses siperfaqesore, shtresen baze dhe bazamentin, a_i perfaqeson koeficientin korrespondues te shtreses, dhe m_i jane koeficientet e drenazhimit per bazen dhe bazamentin. Keta koeficiente a_i dhe m_i mund te percaktohen duke u mbeshtetur ne literaturat e pershtatshme.

Llogaritja e trashesise se shtresave eshte bere duke perdorur Proceduren e Analizes se Trashesise Efektive. Pergjithesisht trashesia llogaritet si:

$T_0 = (SN_{req} - Sn_{eff}) / a_0$

ku:

- T_0 eshte trashesia e nevojshme ne cm;
- SN_{req} eshte SN e shtreses se re ne cm;
- SN_{eff} eshte SN efektive e shtreses ekzistuese ne cm;
- A_0 eshte koeficienti struktural i shtreses.

SN e struktures se mesiperme te shtresave eshte llogaritur me pas, duke qene dhe Numri Struktural i nevojshem. Koeficientet e shtresave te 0.44, 0.14 dhe 0.11 jane pranuar perkatesisht per asfalto betonin, guret e thyer dhe bazamentit natyral.

Cilesia e drenazhimit eshte matur nepermjet kohezgjatjes per largimin e ujit nga shtresa e bazes dhe e tabanit, dhe varet kryesisht nga filtrueshmeria e tyre. Perqindja e kohes pergjate se ciles struktura e shtresave eshte e ekspozuar ndaj nivelet te ngopjes se lageshtise varet nga mesatarja e rreshjeve te shiut dhe te kushteve mbizoteruese te drenazhimit.

Ne kete rast specifik, eshte pranuar se rruga ka nje drenazhim te mire, per kete arsye koeficienti i drenazhimit (m_i) per bazen dhe tabanin do te jete 1.00.

Struktura e mesiperme e shtresave ka nje numer struktural (SN):

Layer No.	Description	Layer Coeff. a_i	Drainage Coeff. m_i	Elastic Modulus, psi	SN Using E of next lower layer in inputs box below	Min. Layer Thickness, D, inches	Practical Layer Thickness, D, inches	Ass. SN
Layer 1	AC Layer	0.44	00	400.000	3.33		4.00	1.76
Layer 2	Gran Base A	0.14	90	35.000	3.47		5.90	0.74
Layer 3	Gran Base 2	0.14	80	20.000	3.84		0.00	0.00
Layer 4	Gran. Subbase	0.11	80	15.000	6.20		9.92	0.87
Subgrade	Subgrade	N/A	N/A	12.000	N/A	N/A	N/A	N/A
					Total Pavement Thickness, inches,	75.08	19.82	3.38 3.26

Dimens. OK

Tabela 34. Zona homogjene 1(0+000 ÷0+540)

Layer No.	Description	Layer Coeff. a_i	Drainage Coeff. m	Elastic Modulus, psi	SN Using E of next lower layer in inputs box below	Min. Layer Thickness, D, inches	Practical Layer Thickness, D, inches	Ass. SN
Layer 1	AC Layer	0.44	1.00	400.000	3.33		3.100	1.36
Layer 2	Gran Base A	0.14	0.90	35.000	3.47		5.90	0.74
Layer 3	Gran Base 2	0.14	0.80	20.000	3.84		0.00	0.00
Layer 4	Gran. Subbase	0.11	0.80	15.000	6.20		9.92	0.87
Subgrade	Subgrade	N/A	N/A	12.000	N/A	N/A	N/A	N/A
					Total Pavement Thickness, inches,		18.92	2.98 2.85

Dimens. OK

Tabela 35. Zona homogjene 2(0+540 3+600)

Layer No.	Description	Layer Coeff. a_i	Drainage Coeff. m_i	Elastic Modulus, psi	SN Using E of next lower layer in inputs box below	Min. Layer Thickness, D, inches	Practical Layer Thickness, D, inches	Ass. SN
Layer 1	AC Layer	0.44	00	400.000	3.33		3.100	1.36
Layer 2	Gran Base A	0.14	90	35.000	3.47		5.90	0.74
Layer 3	Gran Base 2	0.14	80	20.000	3.84		0.00	0.00
Layer 4	Gran. Subbase	0.11	80	15.000	6.20		9.92	0.87
Subgrade	Subgrade	N/A	N/A	12.000	N/A	N/A	N/A	N/A
					Total Pavement Thickness, inches,		18.92	2.98 2.85 Dimens. OK

Tabela 36. Zona homogjene 3(4+050 7+050)

Layer No.	Description	Layer Coeff. a_i	Drainage Coeff. m_i	Elastic Modulus, psi	SN Using E of next lower layer in inputs box below	Min. Layer Thickness, D, inches	Practical Layer Thickness, D, inches	Ass. SN
Layer 1	AC Layer	0.44	00	400.000	3.33		3.100	1.36
Layer 2	Gran Base A	0.14	90	35.000	3.47		3.97	0.5
Layer 3	Gran Base 2	0.14	80	20.000	3.84		0.00	0.00
Layer 4	Gran. Subbase	0.11	80	15.000	6.20		5.95	0.52
Subgrade	Subgrade	N/A	N/A	15.000	N/A	N/A	N/A	N/A
					Total Pavement Thickness, inches,		13.02	2.39 2.29 Dimens. OK

Tabela 37. Zona homogjene 4(7+050 9+100)

Layer No.	Description	Layer Coeff. a_i	Drainage Coeff. m_i	Elastic Modulus, psi	SN Using E of next lower layer in inputs box below	Min. Layer Thickness, D, inches	Practical Layer Thickness, D, inches	Ass. SN
Layer 1	AC Layer	0.44	00	400.000	3.33		3.200	1.41
Layer 2	Gran Base A	0.14	90	35.000	3.47		6	0.76
Layer 3	Gran Base 2	0.14	80	20.000	3.84		0.00	0.00
Layer 4	Gran. Subbase	0.11	80	15.000	6.20		10	0.88
Subgrade	Subgrade	N/A	N/A	7000	N/A	N/A	N/A	N/A
					Total Pavement Thickness, inches,		19.2	3.04 3.04

Dimens. OK

Tabela 38. Zona homogjene 5(9+100 10+050)

5.5.3 Nderhyrjet per Rehabilitim

Seksioni nga 0+540 ne 3+600 - Perforcimi i rruges ekzistuese

Shtresat ekzistuese, me cilesi mesatare, do te riperdoren, pas skarifikimit, dhenies se formes se re dhe kompaktesimit, per te sherbyer si nje platforme punuese per ndertimin e shtresave te reja te nenbazes, bazes, binderit dhe asfalto betonit.

Veprimet qe do te kryhen jane si vijojne:

1 Germimi i shpatullave ekzistuese per nje thellesi variabel.

2 Zgjerimi i argjinatures se rruges deri ne nivelin e bazamentit.

3 Skarifikimi/shtrese ekzistuese deri ne thellesine e plote dhe shperndarja e materialit ne te gjithe gjeresine (duke perfshire zgjerimin), dhenia e formes se re dhe kompaktesimit.

4 Ndertimi i struktures se re te shtresave ne te gjithe gjeresine (shih poshte)

Shtresa ekzistuese prej zhavorri natyral eshte prej materiali te pa selektuar zhavorri. Ky material ekzistues do te ri-perdoret, per dhenien ne formes ne gjeresine e plote dhe shtresat e reja te nenbazes, bazes dhe asfalto betoni do te vendosen menjehere mbi te si vijon.

Paketa e re e shtresave e propozuar eshte:

Shtresa ekzistuese do te riperdoret si bazament pas skarifikimit, dhenies se formes se re dhe kompaktesimit, per te qene si nje platforme pune per ndertimin e shtresave.

Shtresat e reja si asfalto-betoni, stabilizanti dhe nenbaza do te vendosen menjehere mbi bazament. Llogaritjet per trashesine e shtresave te reja jane si me poshte:

Ne menyre qe te percaktohen trashesite e shtresave, duke konsideruar qe struktura e kerkuar e shtresave (shih siper) ka nje numer struktural te barabarte me SN = 3.36, atehere struktura e re e shtresave duke konsideruara dhe kontributin e shtreses se re te asfaltit (4 cm) duke perdorur nje numer struktural 0.4 eshte 3.52

Perfundimisht punimet qe duhen bere nga km. 0+540 ne km. 3+600 jane:

- Pregatitje e siperfaqes se shtresave ekzistuese
- Zgjerimi i trupit te rruges deri ne nivelin e tabanit.
- Shtrimi 25 cm i nenbazes natyrale i shtresave anesore
- Shtrimi 15 cm i stabilizantit prej guresh se thyer i shtresave anesore
- Shtrimi 6 cm i shtreses se binderit i shtresave anesore
- Shtrimi 4 cm i shtreses se tapetit mbi te gjithe rrugen.

Seksioni e tjera- Perforcimi i rruges ekzistuese

Shtresat ekzistuese, me cilesi mesatare, do te riperdoren, pas skarifikimit, dhenies se formes se re dhe kompaktesimit, per te sherbyer si nje platforme punuese per ndertimin e shtresave te reja te nebazes, bazes, binderit dhe asfalto betonit.

Veprimet qe do te kryhen jane si vijojne:

1 Germimi i shpatullave ekzistuese per nje thellesi variabel.

2 Zgjerimi i argjinatures se rruges deri ne nivelin e bazamentit.

3 Skarifikimi/shtrese ekzistuese deri ne thellesine e plote dhe shperndarja e materialit ne te gjithe gjeresine (duke perfshire zgjerimin), dhenia e formes se re dhe kompaktesimit.

4 Ndertimi i struktures se re te shtresave ne te gjithe gjeresine (shih poshte)

Shtresa ekzistuese prej zhavorri natyral eshte deri 20 cm trashesi, prej materiali te pa selektuar zhavorri. Ky material ekzistues do te ri-perdoret, per dhenien ne formes ne gjeresine e plote dhe shtresat e reja te nenbazes, bazes dhe asfalto betoni do te vendosen menjehere mbi te si vijon.

Paketa e re e shtresave e propozuar eshte:

Pas skarifikimit dhe shperndarjes se shtrese ekzistuese (3-4m e gjere) ne te gjithe gjeresine (5m duke perfshire zgjerimin) trashesia qe ngelet e shtreses ekzistuese llogaritet si me poshte:

20. cm x (3 m / 5 m) = 12 cm

ku 5m eshte gjeresia e rruges se re dhe 3m supozohet te jete gjeresia ekzistuese duke konsideruar nje humbje te mundshme te materialit gjate punimeve.

Shtresa ekzistuese do te riperdoret si bazament pas skarifikimit, dhenies se formes se re dhe kompaktesimit, per te qene si nje platforme pune per ndertimin e shtresave.

Shtresat e reja si asfalto-betoni, stabilizanti dhe nenbaza do te vendosen menjehere mbi bazament. Llogaritjet per trashesine e shtresave te reja jane si me poshte:

Ne menyre qe te percaktohen trashesite e stabilizantit dhe nenbazes, duke konsideruar qe struktura e kerkuar e shtresave (shih me lart) ka nje numer struktural te barabarte me SN = 2.85, atehere struktura e re e shtresave duke konsideruar dhe kontributin e shtreses se re te asfaltit (3 cm) dhe binderit (5 cm) duke perdorur nje numer struktural 0.44 eshte 2.98

SNwearing+binder = (5 + 3)/2.52 x 0.44 = 1.4

SNsubbase+base = 2.85 – 1.45 = 0.76

Diferenca prej 0.76 ne Numrin Struktural mund te mbushet keshtu nga nje shtrese stabilizanti 15 cm prej materiali te thyer (SN= 15 x 0.11/2.52 = 0.46) dhe 10 cm prej nenbaze prej zhavorri natyral (SN = 10/2.52 x 0.11 = 0.3).

Perfundimisht punimet qe duhen bere jane:

- Zgjerimi i trupit te rruges deri ne nivelin e tabanit.
- Perhapja e materialit ekzistues ne te gjithe gjeresine, duke i dhene formen e re dhe kompaktesi.
- Shtrimi 10 cm i nenbazes natyrale
- Shtrimi 15 cm i stabilizantit prej guresh se thyer
- Shtrimi 5 cm i shtreses se binderit dhe 3 cm i shtreses se tapetit

5.5.4 Ndjeshmeria ndaj ngricave te materialeve te rruges

Zona e projektit preket nga dimer i ashper.

Projektimi i shtresave siguron nje trashesi totale te shtresave rreth 50 cm; 15 cm baza prej cakelli/zhavorri natyral; 25 cm stabilizant prej guresh te thyer dhe 8-10 cm shtresat bituminoze.

Keshtu eshte supozuar qe 50 cm ne nje zone me ngrica eshte e mjaftueshme duke konsideruar qe:

- te gjitha materialet e propozuara do te jene sipas specifikimeve te ARDM 3 paragrafi 3.9.3.14.3 - Veprimet e ngrirjes;
- kanalet e reja gjatesore dhe pjerresite e medha do te sigurojne nje drenazhim te shpejte te ujrave te rreshjeve

5.6 KONTROLLI I EROZIONIT DHE SISTEMI I MBROJTJES SE SKARPATES

Kushtet e qendrueshmerise se skarpates, si ato te krijuara ashtu edhe ato natyrore jane te ndryshme ne cdo segment.

Rreshqitje dheu dhe prishje morfologjike jane prezente ne formacionet terrigjene. Aty ku ka gelqeror nuk kemi rreshqitje.

Fenomene gjeomorfologjike te hasura mund te permenden ne dy klasa te vecanta:

a) Rreshqitje dheu dhe nderprerje te qendrueshmerise se skarpates, me shkalle te ndryshme rendesie dhe rreziku. Ne kete klase jane perfaqesuar rreshqitjet klasike si ato aktive edhe ato te stabilizuara (te vjetra) dhe ato me pak te rrezikshme si "levizja e dherave te siperm" duke perfshire nje shtrese shume te holle te dheut (vecanersisht humus apo dhera te gerryer). Rreshqitjet ndodhin vetem ne formacionet flishore.

b) Fenomen i forte erozioni. Keto fenomene, te cilet jane vecanerisht per shkak te ujrave qe rrjedhin, ndodhin si ne formacionet kalcite dhe ne formacionet flishore. Zhvillimi i erozionit mund te shkaktoje rreshqitje dheu, vecanerisht ne formacionet flishore.

Rreshqitjet dhe prishjet morfologjike te rendesishme ndodhin vetem ne formacionet e thermuara flishore. Meqenese ne km e fundit te Lot III keto fenomene jane shume te theksuara i kemi studiuar

me vete pasi kerkojne nderhyrje te vecanta inxhinierike.

Qendrueshmeria e skarpates mund te permiresohet nga parashikimi dhe projektimi i nje sistemi te pershtatshem drenazhi. Kjo mund te arrihet duke:

- Nje sistem siperfaqesor drenazhi qe eshte i afte te shkarkoje te gjithe ujrat e rreshjeve;
- Punime mbrojtjeje mund te aplikohen drejtpersedrejti ne siperfaqen e skarpates;

Per sa i perket sistemit te drenazhit, kapitulli 3 pershkruan te gjitha dispozitat e nevojshme per nje funksionim te plote te drenazhit; per me teper ne te njejtin kapitull jane pershkruar sistemet e mbrojtjes kunder erozionit si psh: pengesa me mure per kontrollin e erozionit ne kanale dhe pengesa gabionesh gjate rruges natyrale te ujit me qellim qe te thyhet rrjedhja dhe te reduktohet energjia.

Ne raste te vecanta, ku ka rrezikshmeri rreshqitjesh, eshte e pershtatshme te rritet sistemi i drenazhit nepermjet kanaleve te drenazhit te vendosura ne anen e siperme te rruges nen kanal dhe nje drenazh siperfaqesor te vendosur rreth perimetrit te nje zone te paqendrueshme per te siguruar nje shkarkim te shpejte te ujrave te shiut.

Per dispozitat perkatese, ju lutem referohuni Detajeve Standarde.

Per sa i perket punimeve per mbrojtjen e skarpates, qendrueshmeria e skarpates mund te permiresohet duke:

Mbjellja: objektivi i mbjelljes eshte te mbuloje komplet skarpaten me bimesi. Eshte aplikimi i barit me pleh dhe i ushqyer me uje nepermjet metodes se sprucimit. Fara e barit do te rritet dhe rrenja e barit do te sherbeje si nje fiber organike perforcuese dhe do te mbaje siperfaqen e dheut duke mbrojtur skarpaten nga erozioni



Hydro-seeding

Turfing: eshte aplikimi drejtpersedrejti i barit me rrenje te zhvilluara ne siperfaqen e skarpates. Ky bar relativisht i rritur do te rritet me lehte dhe do te zgjeroje rrenjet e tij ne dhe per te perforcuar siperfaqen.

Wicker qellimi eshte qe te fiksoje ne dhe kunja druri ose shufra hekuri dhe gershetimi i ketyre shufrave do te mbaje dheun, duke rritur kapacitetin vegjetativ. Ato mund te vendosen horizontalisht dhe diagonal.



Wicker living – section



Wicker living – frontal view

Mirembajtja dhe monitorimi i skarpates

Kushtet e nje skarpate mund te perkeqesohen lehte ne nje periudhe te caktuar te kohes keshtu qe duhet ndermarre nje vezhgim i vazhdueshem nga koha ne kohe.

Ashtu si inspektimet paraprake per te percaktuar qendrueshmerine baze te skarpates, edhe inspektimet rutine rekomandohen te ndermerren ne periudha te caktuara te rregullta. Gjate inspektimit duhet te vezhgohen elementet e meposhtem:

1. Garantimi i siperfaqes se skarpates dhe qe kanalet e saj te drenazhit nuk jane te bllokuara.
2. Siperfaqet mbrojtese te demtuara ose te çara dhe sistemi i drenazhit duhet te riparohet dhe te mbahet ne gjendje te mire.
3. Zhbllokimi i pusetave te kullimit dhe drenazheve kohe pas kohe.
4. Riformimi i zonave te gerryera dhe te kompaktesuar dhe rimbjellja.
5. Vezhgimi i shfaqjes se demtimeve te mundshme ne skarpate apo strukturave te tjera mbajtese.
6. Vezhgimi i ndonje parregullesie qe shfaqet ne afersi te skarpates.

5.7 LLOGARITJA GJEOTEKNIKE TE SHKARJEVE NE LOT III (KM 2.3)

5.7.1 Konsiderata te pergjithshme

Zona gjendet ne nje mbihypje tektonike te cilat kane sjelle rreshpezim te madh te argjilave dhe karakteristika fiziko-mekanike shume te keqija. Pjerresite shume te medha gjatesore dhe terthore, prania e ujrave etj (shih raportin gjeologjik) favorizojne shume humbjen e qendrueshmerise se shpatit. Studimin e detajuar gjeologjik vetem per keto shkarje eshte dhene ne APENDIKS

Formacioni ku kalon rruga perben rastin me te keq te kombinimit te faktoreve per qendrueshmerine e shpatit.

Te gjitha zgjidhjet qe mund te jepen kane ne baze te performances se tyre mirembajtje.
Prandaj theksoj se neglizhencat me te vogla ne drejtim te mirembajtjes sjellin deshtimin per çdo zgjidhje.

5.7.2 Alternativat e zgjidhjes

Per te bere nje nderhyrje sa me efikase jane marre disa alternativa zgjidhje te cilat po I paraqesim me poshte:

- ***Nderhyrje pjesshme me mure mbajtes***.

Kjo zgjidhje konsiston ne ndertimin e mureve mbajtes ne zonat me probable te shkarjeve . Ne zonen ku ka rrjedhje te materialit te skarpates mund te behet edhe nje tombino.



Figura 45. Paraqitje grafike e nderhyrjes se mundshme tip 1.

- ***Nderhyrje e pjesshme me mure mbajtes dhe dhera te armuar.***

Pershkrim i nderhyrjes:
Ne zonat me probabel te shkarjeve do te behet germim i skarpates poshte rruges dhe me pas do te mbushet me material granular. Kjo mbushje do te perforcohet me gjeogride dhe do te mbahet nga disa blloqe gabionesh. Siperfaqja e kesaj skarpate do te sistemohet me nje shtrese 20÷30cm çakell dhe me pas me nje shtrese 20÷30cm argjile. Midis shtreses se çakellit dhe argjiles do te shtrihet dhe shtresa e gjeogridit. Shtresat e rruges do te jene sipas paketes se shtresave te dhene ne projekt. Ne ane te rruges do te ndertohet nje mur i vogel mbajtes b/arme. Ndersa nga ana e malit do te behet ndertimi i kanalit b/arme si dhe sistemim i skarpates.
Kjo zgjidhje eshte bere bazuar mbi parametrat gjeoteknike te raportit gjeologjik.
Perpara se te behet zbatimi i punimeve duhet te behet nje raport i kontrrollit te parametrave gjeoteknike si dhe duhet te behet nje raport i detajuar gjeologjik qe te shihen vetite fiziko-mekanike te formacionit si dhe litologjia e sakte.



Figura 46. Paraqitje grafike e nderhyrjes se mundshme tip 2.

Llogaritjet e detajuara gjeoteknike per kete nderhyrje jepen ne APENDIKS

- **Nderhyrje totale**

Kjo zgjidhje konsiston ne ndertimin e mureve mbajtes, dherave te armuar si dhe qepje te shpatit (figura 28). Edhe per kete nderhyrje perpara zbatimit duhet te zbatohen te gjitha pershkrimet dhe kerkesat e paraqitura me lart.



Figura 47. Paraqitje grafike e nderhyrjes se mundshme tip 3(Nderhyrje totale).

- **Nderhyrje dhe mirembajtje.**

Mirembajtja konsiston ne pastrimin dhe ndehyrjen (nqs eshte e nevojshme) ne muret e vegjel pristes ose mbajtes, ne ndertimin e kanalin b/arme si dhe ne sistemimin e skarpatave (figura 29).



Figura 48. Paraqitje grafike e nderhyrjes se mundshme tip 4(Sistemim i skarpatave ekzistuese).

- **Zgjedhja e nje Aksi i ri**

Eshte marre ne konsiderate edhe ndryshimi i aksit, keshtu duke filluar nga perroi te trasojne nje rruge te re ne faqen e djathte te masivit gelqeror ku ngrihet kalaja. Diferenca e kuotave eshte rreth 100m dhe na duhet nje gjatesi rruge prej ≥800m ne menyre qe te mos kalojne pjerresite gjatesore 12%. Ne kete rast rruga do te kalonte ne formacione te qendrueshme gelqerore, do te kishte mirembajtje te vogel dhe do te shmangte te gjitha problemet. Nga ana tjeter kemi pjerresi shume te madhe, do te duhen dy serpentina qe te zgjasin rrugen dhe ndonje problem tjeter qe mund te haset gjate trasimit.

Figura 49.Paraqitje e rruges alternative per ngjitjen ne kala

5.7.3 Krahasimi i zgjidhjeve

- **Nderhyrje e pjesshme me mure mbajtes**

Problem eshte inkastrimi i mureve pasi eshte zgjidhje lokale dhe nuk siguron qendrueshmerine totale te shpatit. Ne rast te keq funksionimit te largimit te ujrave siperfaqesore ose ne raste te ngjarjeve ekstreme (stuhi max me periode 1 here ne 20 vjet) mund te kemi humbje te qendrueshmerise.

- **Nderhyrje e pjesshme me mure mbajtes dhe dhera te armuar.**

Problem inkastrimi i mureve pasi eshte zgjidhje lokale dhe nuk siguron qendrueshmerine totale te shpatit. Ne rast te keq funksionimit te largimit te ujrave siperfaqesore ose ne raste te ngjarjeve ekstreme (stuhi max me periode 1 here ne 10 vjet) mund te kemi humbje te qendrueshmerise. Kerkon kujdes ne zgjedhjen e materialeve mbushes dhe zbatimin e teknollogjise se vendosjes se gjeogridave.

- **Nderhyrje totale**

Per kete nderhyrje kerkohen firma te specializuara pasi duhet te siguroje njekohesisht rritje te qendrueshmerise (qepje shpati) dhe drenim te masivit dhe si kosto totale perafersisht do te shkonte:

10000 Euro/ml.x 450ml = 4,500,000 Euro

- **Aksi i ri**

Ne kete rast rruga do te kalonte ne formacione te qendrueshme gelqerore, do te kishte mirembajtje te vogel dhe do te shmangte te gjitha problemet. Nga ana tjeter kemi pjerresi shume te madhe, do te duhen dy serpentina qe te zgjasin rrugen dhe ndonje problem tjeter qe mund te haset gjate trasimit.

4.7.4 Konkluzione

Nga analizimi i rezultateve mendojme se duhet te dallojme tre perqasje nderhyrje per zgjidhjen e problemeve, nga te cillat dy te parat duhet te zbatohen sa me shpejt qe te mos lejohet degradim i metejshem.

- ***Nderhyrje afat shkurter → Nderhyrje dhe mirembajtje.***
- ***Nderhyrje afat mesme* → Nderhyrje e pjesshme me mure mbajtes dhe dhera te armuar.**
- ***Nderhyrje afat gjate →Nderhyrje totale ose aks i ri.***

Nisur nga veshtiresia e fenomenit theksojme se e vetmja zgjidhje e sigurte eshte nderhyrja totale.

6. SIGURIA NE RRUGE

Ky kapitull paraqet aspekte te sigurise ne rruge qe jane perfshire ne projekt te cilat jane listuar si me poshte:

- Menaxhim i trafikut gjate ndertimit
- Paraqitja e kryqezimeve
- Ndaresit e trafikut
- Vijezimet per kalimin e kembesoreve
- Standartet me objektiv reduktimin e shpejtesise (pervec gjeometrise)
- Sinjalistika
- Ndriçimi i rruges
- Mbrojteset metalike

Me poshte vijon diskutimin per shumicen e tyre. Per parashikime specifike shih "Planimetrine e sinjalistikes".

6.1 MENAXHIMI I TRAFIKUT

Mendimi i konsulenteve eshte se menaxhimi i trafikut gjate ndertimit te rruges eshte nje nga aspektet kryesore nga pikpamja e sigurise ne kete projekt.

Arsyet jane:

- Gjeresi e reduktuar e rruges;
- Pamundesia e terrenit per devijime;

Me kete perspektive, me perjashtim te atyre rasteve ku devijimet e trafikut jane te mundshme, pritet qe trafiku dhe punimet te ndajne hapesiren e disponueshme. Prandaj, eshte e nevojshme qe kontraktori te vendose nje sistem eficent menaxhimi te trafikut (shenja paralajmeruese, shenja informuese, njerez me flamuj) me qellim qe te reduktohet rreziku i konflikteve dhe incidenteve gjate punimeve. Duke patur parasysh se per ndertimin e rruges do te perdoren mjete te renda, atehere rekomandohet qe nje person me flamur paralajmerues te jete vazhdimisht ne vendin e punimeve.

Kontraktorit do ti kerkohet te jape detaje mbi masat e planifikuara ne fazen e ndertimit qe do te implementohen per te garantuar minimizimin e pengesave/nderprerjeve te rrjedhjes se trafikut dhe sigurine e rruges.

Menaxhimi i trafikut duhet bere ne perputhje me Kodin Rrugor te Shqiperise: "*RREGULLORE PER ZBATIMIN E KODIT RRUGOR"* Vol II (Kodi rrugor); *"STANDARTET E SINJALIZIMIT RRUGOR"* (Standarti per Sinjalistiken Rrugore) dhe Manuali i Projektimit te Rrugeve Shqiptare MPRrSh6.



6.1.2 Devijimet e trafikut

Megjithese devijimi i trafikut eshte i veshtire ne projektin e rruges, trafiku duhet te devijohet aty ku do te ndertohet nje ure/tombino e re. Ne kete rast, kontraktori duhet te paraqese nje plan te detajuar ku do te tregohen te gjitha masat qe do te implementohen gjate fazes se ndertimit per te garantuar minimizimin e pengesave/nderprerjeve te rrjedhjes se trafikut dhe sigurine e rruges.

Gjeometria e devijimit duhet te projektohet ne perputhje me Kodin Rrugor te Shqiperise: "*RREGULLORE PER ZBATIMIN E KODIT RRUGOR"* Vol II (Kodi rrugor); *"STANDARTET E SINJALIZIMIT RRUGOR"* (Standarti per Sinjalistiken Rrugore) dhe Manuali i Projektimit te Rrugeve Shqiptare MPRrSh6.

6.2 PARAQITJA E KRYQEZIMEVE

Per sa i perket kryqezimet ato duhet te jene qartesisht te kuptueshme nga drejtuesit e mjeteve dhe planifikimi i tyre, edhe pse shume i thjeshte, te jete i pershtatshem per levizjen e mjeteve; figura e meposhtme tregon nje kryqezim tipik ne forme T.



6.3 MOSPLOTESIMI I STANDARTEVE (KTHESAT E FORTA)

Sic u permend ne pershkrimin e pergjithshem te rruges, projektimi i rruges eshte bere duke u bazuar ne principin e minimizimit te çdo ndikimi ne pronat dhe shpronesimet e tokave. Prandaj alternativa e "largimi nga standarti" u konsiderua si me e mira dhe disa kthesa qe nuk plotesojne standartet nuk u permiresuan.
Per kete eshte propozuar te merren masat e meposhtme te sigurise:

- **Tabela paralajmeruese te vendoset ne afersi te ktheses**



Figure II.4 Bend ahead (right)

Figure II.5 Bend ahead (left)

- **Kthese ne te djathte**



Figure II.466 Sharp deviation of route

Figure II.466

Figure II.468

- **Shenja te reduktimit te shpejtesise**



Figure II.22/c

6.4.1 Vijezimet me profil te ngritur

Vijezimi me profil te ngritur eshte mjeti me efektiv i uljes se shpejtesise. Ato jane vija transversale (prej asfalti ose plastike) pergjate rruges te perdorura per te paralajmeruar drejtuesin me ane te nje efekti vibrues dhe te ndjeshem perpara nje rreziku sic mund te jete nje kthese e forte, nje kryqezim, ulje shpejtesie ne hyrje te nje qendre tregetare apo vendkalim kembesoresh.
Zakonisht nevojiten shenja paralajmeruese ne vendet ku ndertohen keto vija, qe jepen me poshte:

Vijezimet me profil te ngritur mund te perdoren per shembull ne situatat e meposhtme

- perpara uljes se shpejtesie ne nje qender te banuar
- ne afersi te nje kryqezimi te rrezikshem
- perpara nje kthese te forte
- perpara nje te ngrituré.

Kur perdoren keto lloj vijezimesh duhen patur parasysh keto gjera:

- profilat e ngritur duhet normalisht 4 te grupuara
- lartesia e profilit nuk duhet te jete me shume se 10-15 cm
- gjeresia e profilit duhet te jete rreth 0.5 m
- nje grup prej profilash te ngritur zakonisht eshte e mjaftueshme per seksionet me shpejtesi 50 km/h
- profili i fundit i ngritur duhet te jete 30-50 m perpara rrezikut
- tabelat paralajmeruese, n.q.s do te perdoren, duhet te vendosen 20 deri ne 80 m perpara rrezikut ne varesi te shpejtesise
- preferohet qe profilat e ngritur te kene vijezime te verdha termoplastike per dukshmeri me te mire



Ne kete rruge nuk eshte parashikuar ndriçim.

6.4 MBROJTESET METALIKE

Me poshte jane listuar parashikimet per mbrojtese metalike per rrugen
Shkoder – Kala Drisht.

Loti 1 -	13 ml	Guard-rails	majtas-djathtas
Loti 2 -	330 ml	Guard-rails	majtas-djathtas
Loti 3 -	280 ml	Guard-rails	majtas-djathtas